

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6144
E mërkurë, 21 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Më 29 nëntor do të mbahen zgjedhjet në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut **FAQE 2**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHPEJTIM BULLIQI **FAQE 4-5**



GARËN PËR KRYETAR TË PODUJEVËS DO TA FITOJ UNË


Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka mirëpritur caktimin e datës për mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të kësaj komune. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e

re", ai ka shprehur bindjen se më 29 nëntor do ta fitojë këtë garë zgjedhore. Bulliqi ka vlerësuar se mbajtja e këtyre zgjedhjeve në këtë komunë është neglizhuar për qëllime të caktuara. Sipas

kandidatit të LV-së, po të kishte vullnet politik kjo datë ka mundur të caktohet më herët. Bulliqi shpreson se vala e dytë e pandemisë të mos ndikojë në shtyrjen e kësaj date

GLPS-ja: SHUARJA E TASK-FORCËS KUNDËR KORRUPSIONIT, TENDENCË PËR NDËRHYRJE DHE SHTRIRJE TË PUSHTETIT

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka vlerësuar se shuarja e Task-forcës Kundër Korrupsionit është tejet shqetësuese dhe është tendencë e qeverisë për ta shtrirë ndikimin e saj dhe për të ndërhyrë në proceset hetuese të zyrtarëve të lartë politik dhe institucional **FAQE 7**



KOSOVA ËSHTË DUKE PËRGATITUR STRATEGJINË E RE PËR SIGURI KIBERNETIKE **FAQE 3**

EKONOMI



KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS KËRKON LIRIM NGA TVSH-ja NË PRODUKTET VENDORE **F. 8**

KDI-ja: LDK-ja DHE AAK-ja T'I "HEQIN DUART" NGA BORDET PUBLIKE **F. 9**

KULTURË

MKRS-ja NDAN 500 MIJË EURO PËR PROGRAMET PËR TREGUN E PUNËS, PËR 400 TË RINJ PUNËKËRKUES **F. 11**

SPORT

LLAPI HARRON ÇKA ËSHTË FITORJA, ARBËRIA MERR TRI PIKË NË DRENICË **F. 14**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MKRS-ja ndan 500 mijë euro për programet për tregun e punës, për 400 të rinj punëkërkuar

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Vlora Dumoshi, dhe përfaqësuesja e programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Maria Suokko, kanë nënshkruar marrëveshjen e financimit mes MKRS-së dhe UNDP-së për zbatimin e projektit Programet Aktive të Tregut të Punës 2, konkretisht programit të praktikës në punë në Kosovë.

Programi do t'i ndihmojë rreth 400 të rinj të regjistruar në Agjencinë e Punësimit si punëkërkuar që të bëjnë praktikë në punë, në sektorin privat dhe në institucione publike dhe kështu të aftësohen profesionalisht, ndërkaq financimin për gjashtë muaj do ta bëjë MKRS-ja me një fond prej gjysmë milioni euro, që do të zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Do të synohen ato kompani dhe ato institucione të cilat,

pas përfundimit të punës praktike, do të kenë mundësi të ofrojnë mundësi të punës më afatgjatë. Me këtë rast, ministrja Dumoshi ka vlerësuar se nëpërmjet kësaj marrëveshje bëhet e mundur përkrahja e të rinjve në tregun e punës dhe se MKRS-ja ka treguar gatishmëri të përfshihet në këtë kontribut për mbështetjen e të rinjve të Kosovës. "Ne jemi befasuar sivjet, ndonëse kohë pandemie, por interesimi i të rinjve për programet e MKRS-së ka qenë shumë i madh. Vetëm në fushën e edukimit për ndërmarrësi ne kemi paraparë të certifikojmë 400 të rinj, por për shkak të interesimit të lartë kemi shpërndarë mbi 1 200 certifikata për të rinjtë. Për planet për vitin e ardhshëm ne do ta rrisim buxhetin për trajnime për të rinjtë. Duke e parë tërë këtë interesim si dhe vështirësitë që kanë të rinjtë, ne bazë të kapaciteteve që kemi për këtë vit, kemi kontribuar për të



rinjtë në punën praktike që t'i ndihmojmë ata", ka thënë ministrja Dumoshi.

Ndërkaq përfaqësuesja e UNDP-së, Suokko, shprehu falënderim për ministren

Dumoshi dhe MKRS-në për besimin ndaj UNDP-së, që ajo ta zbatojë projektin për tregun e punës. "Për shkak të pandemisë të rinjtë janë ndër më të prekurit dhe kjo përkrahje që po jepni do

të jetë e dobishme për ta, andaj ju falënderoj për reagimin e shpejtë dhe gatishmërinë që në kohë krize keni ndërmarrë veprime për përkrahjen e të rinjve", u shpreh Suokko.

Ministria ruse e Mbrojtjes hap zyrë në Serbi

PRISHTINË, 20 TETOR - Ministria e Mbrojtjes e Serbisë njoftoi se ka nisur procedurën për hapjen e zyrës përfaqësuese të Ministrisë ruse të Mbrojtjes, në përputhje me një marrëveshje midis Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Rusisë. "Qëllimi i krijimit të zyrës përfaqësuese të Ministrisë së Mbrojtjes së Rusisë është të ofrojë mbështetje dhe zgjidhje më të shpejtë të çështjeve që lidhen me ndihmën ushtarake-teknike, bashkëpunimin ushtarak dhe ushtarako-teknik, në përputhje me marrëveshjen e Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Rusisë për bashkëpunimin ushtarako-teknik", thuhet në njoftim.

Aty, po ashtu, theksohet se marrëveshja është nënshkruar në bazë të një pajtimi midis presidentëve të Serbisë dhe Rusisë, Aleksandar Vuçiq dhe



Vladimir Putin.

Agjencia e lajmeve "Reuters" ka raportuar se Rusia e ka autorizuar Ministrinë e saj të

Mbrojtjes ta hapë zyrën e saj në Serbi në bazë të një dokumenti të Qeverisë në Moskë. Muajin e kaluar Serbia i ka pezulluar

stërvitjet ushtarake me ushtritë e huaja për gjashtë muaj, duke thënë se ka pasur presion nga BE-ja për t'u tërhequr nga

stërvitjet e përbashkëta me Rusinë dhe Bjellorusinë.

Urdhri i qeverisë ruse për hapjen e zyrës në Serbi daton nga 15 tetori dhe është nënshkruar nga kryeministri rus Mikhail Mishusti. Sipas saj, shefi i zyrës së propozuar do të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve ushtarake dhe teknike, në lidhje me bashkëpunimin ruso-serb.

Marrëveshja, pasi të nënshkruhet nga të dyja palët, do t'i japë një zyrtari rus në Serbi të drejtën për t'i vizituar divizionet serbe që përdorin armë dhe pajisje ushtarake ruse, me kusht që ato të njoftohen paraprakisht dhe ta japin pëlqimin e tyre. Vitet e fundit Serbia ka blerë aeroplanë luftarakë MiG-29 nga Rusia, si dhe helikopterë, tanke dhe transportues të blinduar.

Kufiri detar, Shqipëria dhe Greqia pajtohen t'i drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare

TIRANË, 20 TETOR - Shefi diplomacisë greke Nikos Dendias ka mbërritur të martën në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë nën masa

të forta sigurie, ku temë diskutimi me autoritetet shqiptare ishte zgjidhja e kufirit detar.

Kryeministri Edi Rama dhe


Nikos Dendias u pajtuan për t'i dhënë fund sagës dhe polemikave në dy vendet tona për kufirin detar ku, sipas tyre, zgjidhja është në dorën e një

arbitri ndërkombëtar. "Nuk do të ketë një pushtim grek të detit. Kemi rënë dakord t'i drejtohem drejtësisë ndërkombëtare në bazë të të

drejtës ndërkombëtare. Më vjen keq për patriotët e detit. Nuk është më çështje të bëjnë propagandë kundërgreke për elektorat", ka thënë Rama.

Kosova është duke përgatitur strategjinë e re për siguri kibernetike

Koordinatori Nacional për Siguri Kibernetike, Zafir Berisha, ka bërë me dije të martën se Ministria e Punëve të Brendshme është duke hartuar projektligjin për siguri kibernetike. Qëllimi i këtij ligji do të jetë që t'i përcaktojë parimet e sigurisë kibernetike, parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik në Republikën e Kosovës kundër çdo kërcënimi apo sulmi, si dhe themelimin dhe Autoritetin Shtetëror për Siguri Kibernetike



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 TETOR - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Zafir Berisha, njëherësh Koordinator Nacional për Siguri Kibernetike, ka marrë pjesë të martën në konferencën ndërkombëtare për Siguri Kibernetike të organizuar nga MPB dhe UNDP. Gjatë kësaj konference Berisha ka thënë se, krahasuar me vendet e rajonit, Republika e Kosovës e ka shpërndarjen më të madhe të internetit. Ai ka theksuar se

aktualisht janë duke u punuar strategjia e re për siguri kibernetike dhe plani i veprimit për periudhën vijuese.

Në këtë konferencë zëvendësministri Zafir Berisha ka thënë se Republika e Kosovës ka aprovuar ligjin për infrastrukturën kritike. Qëllimi i këtij ligji është për të ruajtur dhe mbrojtur infrastrukturën kritike kombëtare dhe evropiane, për t'i mbrojtur qytetarët e Republikës së Kosovës, parandaluar incidentet dhe minimizuar dëmin potencial për infrastrukturën kritike, pasurinë

e përgjithshme, humbjet ekonomike dhe sociale. Koordinator Nacional për Siguri Kibernetike, Zafir Berisha, ka theksuar se Ministria e Punëve të Brendshme është duke hartuar projektligjin për siguri kibernetike. Qëllimi i këtij ligji

do të jetë që të përcaktojë parimet e sigurisë kibernetike, parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik në Republikën e Kosovës kundër çdo kërcënimi apo sulmi, si dhe themelimin e Autoritetit Shtetëror për Siguri Kibernetike.

Në këtë konferencë u tha se Republika e Kosovës është zotuar t'i promovojë stabilitetin dhe sigurinë jo vetëm brenda vendit, por edhe të jetë kontribuuese e rëndësishme ndaj sigurisë së rajonit dhe më gjerë.

KEDS-i po aftëson për siguri në punë nxënësit e 69 shkollave profesionale



PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Në kuadër të javës evropiane për siguri dhe shëndet në punë, KEDS-i ka filluar aftësimin për siguri në punë për nxënësit e shkollave të mesme teknike-profesionale. Tashmë ekspertët e kompanisë u kanë dhënë njohuri të vlefshme nxënësve të shkollave në Mitrovicë, Drenas, Ferizaj e Kaçanik. Këta nxënës llogaritet që shumë shpejt mund të hyjnë në tregun e punës, prandaj KEDS-i është fokusuar pikërisht aty. Që nga e hëna, kur

edhe filloi java e sigurisë, trajnerët profesionalë të kompanisë kanë filluar t'iu ligjërojnë atyre bazuar në materiale të përgatitura enkas për ta.

Zekirja Baftiu, drejtor i Shkollës së Mesme Profesionale "Feriz Guri" dhe "Vëllezërit Caka" në Kaçanik është ndarë mjaft i kënaqur me ligjërimin e realizuar nga KEDS-i derisa tha se nxënësit e kësaj shkolle kanë arritur të tregojnë sukses edhe në fushën profesionale duke u

angazhuar si punëtor të KEDS-it. "Vizita e sotme nga KEDS-i, ku u ligjërua për sigurinë dhe shëndetin në punë, ishte shumë e mirëseardhur për nxënësit tanë. Përmes ligjëratave të tilla ata arrijnë që të aftësohen me njohuri të reja nga ekspertët të fushës së sigurisë dhe shëndetit, duke qenë kështu të gatshëm për tregun e punës", ka thënë ai, duke shtuar se bashkëpunimi me KEDS-in ka bërë që të rritet interesimi për nxënësit të cilët ende nuk kanë ndarë mendjen

se ku të orientohen në shkollim të mëtutjeshëm. "Që kur KEDS-i ka filluar të marrë në punë nxënës të shkollës sonë përmes KEDS Akademisë, ka pasur interesim të shtuar të nxënësve për ta vazhduar shkollimin e mesëm në shkollën tonë", ka deklaruar Baftiu.

Mjaft i kënaqur me këtë ligjëratë u nda edhe nxënësi i vitit të fundit të kësaj shkolle, Flakron Tusha. "Ligjëratat e sotme na mundësoi të marrim njohuri të reja në fushën e sigurisë dhe

shëndetit në punë. Krahas asaj që kemi mësuar deri më sot në shkollën tonë, ligjëruesit e KEDS-it na informuan me praktika të reja dhe mjaft të nevojshme sesi duhet të ruhem dhe të kemi kujdes kudo që veprojmë", ka thënë a Flakroni. Me qëllim të rritjes së sigurisë edhe për fëmijët, KEDS-i ka përgatitur gjithashtu një broshurë me skica të detajuara për sigurinë e tyre ndaj kontaktit me energjinë elektrike si brenda shtëpisë, ashtu edhe jashtë saj.



Flet për “Epokën e re”, Shpejtim Bulliqi

GARËN PËR KRYETAR TË PODUJEVËS DO TA FITOJ UNË

Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka mirëpritur caktimin e datës për mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të kësaj komune. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e

re”, ai ka shprehur bindjen se më 29 nëntor do ta fitojë këtë garë zgjedhore. Bulliqi ka vlerësuar se mbajtja e këtyre zgjedhjeve në këtë komunë është neglizhuar për qëllime të caktuara. Sipas

kandidatit të LV-së, po të kishte vullnet politik kjo datë ka mundur të caktohet më herët. Bulliqi shpreson se vala e dytë e pandemisë të mos ndikojë në shtyrjen e kësaj date

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 TETOR - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka shprehur lumturi për caktimin e datës për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar

të kësaj komune. Ai ka shprehur bindjen se më 29 nëntor do të arrijë fitore në këtë komunë, e cila konsiderohet bastion i LDK-së që 20 vjet.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se llapjanët janë ngopur me qeverisjen e deritashme, e cila,

sipas tij, ka abuzuar me të mirat publike. “Ne jo që jemi optimistë, por jemi të bindur se qytetarët llapjanë tashmë kanë provuar për këta 20 vjet pushtetin e kësaj klase qeverisëse, e cila kryesisht ka qeverisur duke abuzuar me të mirat publike dhe duke keqpërdorur në mënyra të

ndryshme buxhetin komunal. Prandaj, besoj se qytetarët llapjanë tashmë e dinë se cili do të jetë drejtimi i qeverisjes lokale nga Lëvizja Vetëvendosja”, ka thënë ai.

Bulliqi ka vlerësuar se ky mandat jo i plotë do t'i mjaftonte atij për ndaljen e keqpërdorimeve në

komunë. “Ju e dini se këto janë zgjedhje për një periudhë të shkurtër kohore. Derisa të mbyllet ky proces mbetet më pak se një vit për të qeverisur dhe sigurisht se do të jetë vështirë për të ofruar premtime të mëdha. Por, besoj se kjo periudhë kohore do të mjaftojë të ndalen këto

keqpërdorime dhe abuzime të këtij pushteti lokal”, ka vlerësuar ai.

Megjithatë, kandidatin e IV-së është duke e shqetësuar fakti pse kjo datë e mbajtjes së zgjedhjeve është shtyrë aq shumë. Bulliqi ka thënë se duke pasur parasysh kohën e pandemisë dhe mundësinë e valës së dytë të koronavirusit, data është dashur të vendoset më herët. “Po të ekzistonin vullneti dhe dëshira e aktorëve të caktuar për t’i mbajtur këto zgjedhje, ka pasur mundësi që ky proces të mbahet më shpejt. Megjithatë, ne shpresojmë që të mos rritet vala e të infektuarve, pra që pandemia të jetë në kontroll dhe këto zgjedhje të mbahen pa ndonjë problem”, ka deklaruar Bulliqi.

“Epoka e re”: Z. Bulliqi, presidenti i vendit ka vendosur që më 29 nëntor të mbahen zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës. Si e keni parë këtë vendim të presidentit për këtë datë?

Bulliqi: Ne e kemi marrë edhe zyrtarisht këtë informacion. Si subjekt politik prej muajit qershor kemi kërkuar që këto zgjedhje të organizohen dhe të përfundojnë, sepse ishte një proces që kishte mbetur në gjysmë. Mirëpo zvarritjet që kanë ndodhur për këtë proces po del se kanë qenë të pajustificueshme. Ky proces ka mundur të kryhet shumë më herët. Sidoqoftë, kjo shtyrje dhe përzgjedhja e kësaj date në muajin e ftohtë të dimrit, na lë të kuptojmë se shtyrja e deritashme e kësaj date është

bërë me një tendencë të caktuar. Sidoqoftë, ne si subjekt politik kemi gatishmërinë që t’i futemi këtij procesi, sepse edhe më herët i kemi bërë përgatitjet. Gjatë kësaj periudhe kohore do t’i shtojmë përgatitjet deri në zgjedhje. Shpresojmë shumë se në këto zgjedhje do të dalim fitues.

“Epoka e re”: Pse mendoni se ky proces është zvarritur qëllimshëm?

Bulliqi: Këto janë zgjedhje të jashtëzakonshme. Edhe data e parë për këto zgjedhje që ishte caktuar më 15 mars nuk ishte lënë një afat kaq i gjatë kohor. Pra, tani kemi pesë javë diferencë deri në mbajtjen e këtij procesi. Mendoj se po të kishte ekzistuar vullneti politik do të kishte mjaftuar një periudhë kohore dhjetëditore për të organizuar dhe përfunduar në mënyrë të suksesshme këtë proces. Sidoqoftë, ne si Lëvizje Vetëvendosje i respektojmë këto vendime dhe do të punojmë shumë që në fund të këtyre zgjedhjeve të dalim fitimtarë. Pra, që ta ndryshojmë pushtetin në Komunën e Podujevës.

“Epoka e re”: Cila do të jetë oferta juaj politike për qytetarët e kësaj komune?

Bulliqi: Ju e dini se këto janë zgjedhje për një periudhë të shkurtër kohore. Derisa të mbyllet ky proces mbetet më pak se një vit për të qeverisur dhe sigurisht se do të jetë vështirë për të ofruar premtime të mëdha. Por, besoj se kjo periudhë kohore do të mjaftojë të ndalen këto keqpërdorime dhe abuzime të

këtij pushteti lokal. Mendoj se do të jetë e mjaftueshme që të parapërgatitemi për zgjedhjet e rregullta lokale të cilat pritet të mbahen në vitin e ardhshëm. Sigurisht se ka shumë keqpërdorim të pushtetit, duke filluar nga gjërat më të imta e deri te punësimet mbi baza partiake. Pastaj ka forma të ndryshme abuzive në pushtetin lokal dhe shumë lëshime të tjera të mëdha të cilat i ka bërë ky pushtet. Prandaj, mendoj se kjo periudhë e shkurtër kohore do të mjaftojë që të ndalet kjo e keqe dhe të fillohet të punohet për së mbari në të gjitha fushat.

“Epoka e re”: Pra, jeni optimistë se do ta fitoni këtë garë zgjedhore më 29 nëntor, ani pse garoni në një komunë e cila prej 20 vjetësh është bastion i LDK-së?

Bulliqi: Ne jo që jemi optimistë, por jemi të bindur se qytetarët lllapanë tashmë kanë provuar për këto 20 vjet pushtetin e kësaj klase qeverisëse e cila kryesisht ka qeverisur duke abuzuar me të mirat publike dhe duke keqpërdorur në mënyra të ndryshme buxhetin komunal. Prandaj, besoj se qytetarët lllapanë tashmë e dinë se cili do të jetë drejtimi i qeverisjes lokale nga Lëvizja Vetëvendosja. Po ashtu, unë si kandidat kam bukur shumë njohuri për qytetarët e kësaj komune, prandaj jam shumë optimist se ne do të dalim fitimtarë në këtë proces.

“Epoka e re”: Kësaj here fushata zgjedhore dhe zgjedhjet do të mbahen në kohë pandemie. Sa do të jeni të kujdesshëm që

tubimet tuaja të mos ndikojnë në përhapjen e kononavirusit?

Bulliqi: Kam besimin e plotë se tashmë të gjitha masat janë liruar dhe sigurisht se duhet pasur kujdes për t’i respektuar rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Dhe gjithsesi edhe ne si subjekt politik do të jemi shumë të vëmendshëm që qytetarët tanë të kenë një siguri maksimale gjatë mbarëvajtjes së këtij procesi zgjedhor. Para së gjithash, ne shpresojmë që puna e pandemisë do të ecë me ritme ngadalësuese, çfarë është tash. Pra, që të mos kemi rritje të të infektuarve dhe besoj se do të përmbyllet suksesshëm ky proces zgjedhor.

“Epoka e re”: Meqenëse IKShPK-ja dhe qeveria po paralajmërojnë një valë të dytë të koronavirusit, a ju shqetëson fakti se shtimi i rasteve mund të çojë përsëri në anulimin e këtij procesi?

Bulliqi: Për këtë arsye e thashë në fillim se nuk ka pasur asnjë justifikim shtyrja aq e madhe e datës së këtyre zgjedhjeve sepse, sipas parashikimeve, pritet valë e re e përhapjes së virusit Covid-19. Prandaj, këtu shtohet dilema se cila ka qenë arsyeja e shtyrjes kaq e madhe e kësaj date kur ka mundur të caktohet ndonjë datë më e afërt. Pra, po të ekzistonin vullneti dhe dëshira e aktorëve të caktuar për t’i mbajtur këto zgjedhje, ka pasur mundësi që ky proces të mbahet më shpejt. Megjithatë, ne shpresojmë që të mos rritet vala e të infektuarve, pra që pandemia të jetë në kontroll dhe këto zgjedhje të mbahen pa ndonjë problem.

Haki Rugovës i hiqet masa e arrestit shtëpiak

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Gjykata e Apelit ka vendosur lidhur me ankesat e avokatëve mbrojtës kundër caktimit të masës së arrestit shtëpiak ndaj të pandehurve Haki Rugova dhe L. B. Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, i datës 11 tetor 2020, është ndryshuar. Të pandehurve u është caktuar masa e ndalimit për t’iu afruar vendit, apo personit të caktuar. “Konkretisht atyre u është ndaluar që t’i afrohen një dëshmitari, në distancë më të afërt se 100 metra e, po ashtu, iu është ndaluar çdo komunikim me të në kohëzgjatje prej një muaji. Me këtë aktvendim të pandehurve u bëhet me dije se në rast se e shkelin këtë masë, gjykata mund ta urdhërojë paraburgimin. Gjykata e Apelit vlerësoj se edhe me këtë masë mund të arrihet qëllimi për të cilin është caktuar masa e arrestit shtëpiak, prandaj edhe vendosi konform dispozitave të nenit 177 par. 1, nën par. 1.2 dhe 1.3 të Kodit të Procedurës

Penale”, thuhet në njoftimin për media.

Gjykata konsideron se nisur nga pesha e veprave penale, mënyra, rrethanat dhe koha në të cilën dyshohen të jenë kryer ato, masa e ndalimit për t’iu afruar vendit apo personit, është masë e mjaftueshme, për ta zvogëluar rrezikun që të pandehurit të ndikojnë në prova ose dëshmitarë, apo edhe të kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Haki Rugova po dyshohet, nga ana e prokurorisë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale “Konflikt i interesit”, “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe vepër penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar”, ndërsa L. B. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Falsifikim i dokumentit zyrtar”. Të gjitha këto vepra të dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.



Kosova kushtëzon marrëveshjen finale me çështjen e të pagjeturve



PRISHTINË, 20 TETOR - Pa kapitullin për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë nuk mund dhe nuk do të ketë marrëveshje përfundimtare me Serbinë, kanë deklaruar zyrtarët e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur në Kosovë. Deklaratat e tilla janë bërë gjatë mbledhjes të së hënës të këtij Komisioni. Por, përfaqësues të Fondit për të Drejtën Humanitare si dhe të Shoqatës “Zëri i prindërve”, qendër kjo e familjarëve të personave të pagjetur në Kosovë, kanë ngritur dyshimin se a do të zgjidhet fati i personave të pagjetur në rast se nuk do të arrihet marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas deklaratave të palëve në dialogun në Bruksel, çështja e të pagjeturve është një prej pikave për të cilën është arritur harmonizimi i qëndrimeve. Por, pa një marrëveshje përfundimtare nuk mund të zbatohet asnjë pikë veç e veç, për të cilat pajtohen palët, ka deklaruar për Radion Evropa e Lirë, Kushttrim Gara, udhëheqës i njësisë në kuadër të Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur. “Përkundër pajtimeve,

megjithatë është thënë se nuk do të ketë marrëveshje për tema specifike pa u arritur marrëveshja në tërësi”, ka thënë Gara.

Të njëjtën gjë e ka thënë më herët edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, më 12 tetor, në Kuvendin e Kosovës, në interpelancën lidhur me rrjedhën e deritashme të procesit të dialogut me Serbinë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Hoti theksoi se “çdo pajtim, për cilado elemente të marrëveshjes, është pajtim vetëm parimor, sepse nuk ka pajtim për asgjë përderisa nuk ka pajtim për çdo gjë, përkatësisht përderisa nuk ka pajtim për njohje reciproke”. Deri më tash, para se çështja e të pagjeturve të bëhej temë në dialogun e Brukselit, për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur ka punuar grupi punues, i cili përbëhet nga dy delegacionet, i Kosovës dhe i Serbisë.

Në mbledhjen e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur në Kosovë, më 19 nëntor, Ibrahim Makolli, kryesues i delegacionit të Kosovës për bisedime për çështjen e të pagjeturve në grupin punues, ka theksuar se

në dialogun e Brukselit është arritur pajtimi për shtyllat, që janë parime, për çështjen e të pagjeturve. “Është krijimi i një komisioni të përbashkët, i udhëhequr nga një i emëruar special i Bashkimit Evropian, mekanizëm ky i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e procesit të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur. Ndërkaq që mekanizmat e tjerë në terren do të jenë po të njëjtët, të cilët kanë vepruar deri më tash. E dyta është qasja e pakufizuar në të gjitha arkivat vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato të ushtrisë, të policisë dhe të forcave të tjera të Serbisë, të cilat kanë marrë pjesë në kryerjen e krimeve në Kosovë dhe fshehjen e trupave të të vrarëve dhe të masakruarve”, ka thënë Makolli.

Ai, gjithashtu, ka shtuar se realizimi i gjithë këtij procesi parashihet të kryhet brenda afatit kohor prej 18 muajve, që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes përfundimtare eventuale. Por, pajtimi për këto parime, siç ka thënë ai, do të hyjë në fuqi vetëm nëse arrihet marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

KUSHTËZIMET DHE DILEMAT

Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare thotë për Radion Evropa e Lirë se për procesin e dialogut në Bruksel, përfshirë këtu edhe çështjen e personave të pagjetur brenda këtij procesi, nuk ka pasur transparencë. Megjithatë, sipas tij, kushtëzimi i realizimit të qëndrimeve të harmonizuara të të dyja palëve për çështjen e të pagjeturve me marrëveshjen përfundimtare, ngrë dilema. “Po besoj se opinioni duhet të jetë koshient dhe nuk e di se a do të realizohen pritjet, në rend të parë të familjarëve të zhdukur. Do të ishte dëm i madh në rast se nuk arrihet marrëveshja përfundimtare. Kjo do të thotë se edhe pikat në marrëveshjen e vogël (për të pagjeturit) nuk do të zbatohen. Është paksa një situatë e çuditshme, sepse kjo lë për të kuptuar që palët mund të kontribuojnë më shumë për zbardhjen e fatit (të pagjeturve), mirëpo nëse nuk arrihet marrëveshja përfundimtare, nuk do t’i kryejnë ato zotime”, theksoi Blakaj. Bajram Qerkini, drejtuesi i shoqatës “Zëri i prindërve”,

qendër kjo e familjarëve të personave të pagjetur në Kosovë, thotë për Radion Evropa e Lirë që informacionet se për çfarë janë pajtuar palët në Bruksel lidhur me çështjen e të pagjeturve kanë munguar. Megjithatë, ai nuk beson se çështja e të pagjeturve do të zgjidhet në rast se ajo mbetet peng i një marrëveshjeve përfundimtare gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “As nuk besoj që kanë për të nënshkruar një marrëveshje apo kanë për ta realizuar atë. Sikurse deri më tash, e gjejmë një tjetër problem, i cili e stagnon edhe për një vjet, pastaj prapë edhe një vjet dhe kështu me radhë. E kemi një optimizëm dhe një besim që Amerika ka ndërhyrë me qëllim, më duket, jashtëzakonisht të mirë”, tha Qerkini.

Çështja e të pagjeturve gjithashtu është pjesë e dokumenteve të nënshkruara, më 4 shtator, nga kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Uashington, në prani të presidentit amerikan Donald Trump. Të dyja palët janë zotuar se do t’i përshpejtojnë përpjekjet që t’i lokalizojnë dhe identifikojnë mbetjet e personave të zhdukur.

GLPS-ja: Shuarja e Task-forcës Kundër Korrupsionit, tendencë për ndërhyrje dhe shtrirje të pushtetit

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka vlerësuar se shuarja e Task-forcës Kundër Korrupsionit është tejet shqetësues dhe është tendencë e qeverisë për ta shtrirë ndikimin e saj dhe për të ndërhyrë në proceset hetuese të zyrtarëve të lartë politik dhe institucional

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 TETOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka reaguar ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta shuar Task-forcën Kundër Korrupsionit në kuadër të Policisë së Kosovës. Sipas GLPS-së, shuarja e Task-forcës Kundër Korrupsionit është tejet shqetësues dhe është tendencë e qeverisë për ta shtrirë ndikimin e saj dhe për të ndërhyrë në proceset hetuese të zyrtarëve të lartë politikë dhe institucionalë. "Task-forca Kundër Korrupsionit ishte krijuar me vendim të Qeverisë nr. 02/110 në kuadër të Departamentit të Hetimeve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), si një ndër hallkat kryesore në hetimin e

korrupsionit të profilit të lartë. Pa paragjykuar performancën e kësaj Task-force dhe rezultatet konkrete të kompetencave të saj, rikujtojmë që e njëjta është lavdëruar si një ndër hallkat më të suksesshme në luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, përfshirë këtu edhe raportet ndërkombëtare si Raporti për Vëndin dhe ato nga EULEX-i. Për më tepër, të njëjtat institucione kanë rekomanduar fuqizimin e kësaj Task-force, kurse qeveria ka vepruar plotësisht kundër këtij rekomandimi duke e shuar atë në tërësi", është thënë në reagimin e GLPS-së.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka theksuar se ky vendim kundërthënë është marrë pa asnjë arsytim të qëndrueshëm dhe në një kohë kur Kosova do të duhej të

ndërmerre hapa pozitivë për luftimin e korrupsionit të profilit të lartë, ndër të tjera, si parakusht për vendimin për liberalizim të vizave. "Është tejet shqetësues fakti që është shndërruar në normë të pranueshme praktika që secili koalicion qeverisës, me të marrë pushtetin, shkarkon udhëheqës të institucioneve kyçe, për t'i zëvendësuar ata me individë partiakë dhe në shërbim të

interesave të tyre. Ky veprim vjen në vazhden e vendimeve të tjera të njëpasnjëshme të kësaj qeverie, të cilat seriozisht minojnë përpjekjet e Kosovës për t'i luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin", është thënë në këtë reagim.

GLPS-ja ka bërë me dije se ka qenë një ndër organizatat kritikuese në kohën kur kjo Task-force është krijuar për faktin që e njëjta është themeluar me

vendim të qeverisë. "Mirëpo forma e krijimit të një mekanizmi nuk e arsyeton shuarjen e tij, pa argumente të qëndrueshme dhe transparente. Prandaj, i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që seriozisht ta rishikojë qasjen dhe t'i ndalojë përpjekjet për të ndikuar mbi mekanizmat përgjegjës për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", është thënë në reagimin e GLPS-së.

Edhe 130 raste të reja me Covid-19 dhe një viktimë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 TETOR - Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 818 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 130 raste pozitive me

Covid-19.

Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes (një rast nga Spitali i Përgjithshëm, Gjilan). Numri total i rasteve pozitive është 17 139 raste nga 81 704 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 657 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 71 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 787 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 695. Rastet e fundit pozitive janë

nga: komuna Prishtinë 52 raste, komuna Gjilan 16 raste, komuna Mitrovicë 8 raste, komuna Podujevë 8 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Dragash 5 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Pejë 4 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Deçan 3 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Malishevë 3 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Lipjan, Skenderaj dhe Suharekë.

Më 29 nëntor do të mbahen zgjedhjet në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, të cilat janë caktuar që të mbahen më 29 nëntor. Sipas njoftimit nga Presidencia, zgjedhjet në këto dy komuna do të mbahen në "koordinim dhe bashkërendim me institucionet përkatëse, në

pajtim me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë".

Presidenti Thaçi më herët kishte shtyrë mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në këto dy komuna për, siç ishte thënë, parandalimin e përhapjes së koronavirusit të ri. Komuna e Podujevës ka mbetur pa kryetar qysh në fillim të shkurtit, kur Agim Veliu ka dhënë dorëheqje, pasi është

emëruar ministër i Punëve të Brendshme në qeverinë e ish-kryeministrit Albin Kurti.

Pa kryetar, nga fillimi i qershorit, ka mbetur edhe Mitrovica e Veriut, pasi Goran Rakiq, nga Lista Serbe, është emëruar zëvendëskryeministër dhe ministër i Pushtetit Lokal në qeverinë e re të Avdullah Hotit. Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve.



Reçica me hapa konkretë për implementimin e marrëveshjes me Shqipërinë për mobilitet në punë

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, bashkë edhe me zëvendëskryeministren Albulena Balaj-Halimaj, kanë pritur të martën në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, për të diskutuar lidhur me hapat që MPMS-ja ka ndërmarrë në

funkcion të implementimit të Marrëveshjes për Mobilitet për Punë, që është nënshkruar në mbledhjen e fundit të dy qeverive.

Ministri i MPMS-së, Skender Reçica, u shpreh se me mbështetjen e madhe edhe të zëvendëskryeministres Balaj-Halimaj janë të gatshëm për ta jetësuar sa më parë këtë

marrëveshje, që për qëllim ka përmirësimin e fushës së punësimit dhe aftësimin profesional, integrimin e një tregu të përbashkët të punës Kosovë - Shqipëri, përmbushjen e nevojave të qytetarëve për lëvizje të lirë të punëtorëve, hapjen e horizonteve të bashkëpunimit dhe integritimit andej dhe këndej kufirit.



Klubi i Prodhuesve të Kosovës kërkon lirim nga TVSh-ja në produktet vendore



PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Klubi i Prodhuesve kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës ta

mundësojë kthimin e TVSh-së për blerje të produkteve dhe shërbime vendore. Kështu të

gjithë qytetarët e vendit të cilët blejnë produkte vendore ose kërkojnë shërbime vendore t'u

kthehet e gjithë vlera e TVSh-së së paguar. "Një masë e tillë do t'i inkurajonte blerjet e

prodhimeve vendore, stimulonte konsumin dhe do t'i ndihmonte punëtorët në fabrikat tona që t'i ruajnë vendet e tyre të punës në këtë kohë të pandemisë. Përkrahja e kompanive prodhuese të produkteve dhe shërbimeve vendore është e domosdoshme sidomos tani kur shumë shtete janë duke i përkrahur kompanitë prodhuese të vendit", është thënë në komunikatën e Klubit të Prodhuesve, duke theksuar tutje se një masë e tillë e ka ndërmarrë edhe Maqedonia e Veriut, ku qytetarët atje gjatë periudhës së fundjavës kanë mundësinë të blejnë produkte dhe shërbime maqedonase ku pas blerjes TVSh-ja u kthehet në llogaritë e tyre.


Ministri Kuçi përruron ujësjellës në fshatra të Suharekës

SUHAREKË, 20 TETOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka marrë pjesë të martën në përrurimin e ujësjellësit në fshatin Nëpërbisht të Suharekës, projekt i përbashkët në mes të Komunës së Suharekës, CDI-së zvicerane dhe Hidroregjionit Jugor. Ministri Kuçi u shpreh i kënaqur me këtë zhvillim, që i paraprinë edhe përrurimit të ujësjellësit në fshatrat Reqan dhe Maqitevë, duke i bërë këto fshatra me ujë të pijshëm të kontrolluar. Përpos këtij

projekti, ministri tregoi edhe për projektin që do t'i zgjidhë përgjithmonë Suharekës problemin e ujit të pijshëm. "Dua ta shfrytëzoj momentin për të treguar që e kemi biseduar bashkë me kryetarin për mundësitë e investimeve nga niveli qendror, bashkë edhe me Hidroregjionin, që kanë të bëjnë me rezervarin e madh të Pusi i Atit, me ç'rast ministria ka ndarë apo ka planifikuar buxhet për vitin e ardhshëm diku në vlerë prej 800 mijë eurosh. Ai rezervar shton sasinë e ujit në qytet, po

ashtu bën mbulimin e të gjitha lagjeve me furnizim me ujë në qytet", ka thënë Kuçi, duke përmendur edhe mundësinë e furnizimit nga Radoniqi për fshatrat e anës që lidhen me Mamushën.

Kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, ka treguar se projekti ka kushtuar 425-mijë euro, duke potencuar se ka lagje që do të shkojë uji për herë të parë tash. Ndërsa kryeshefi i Hidroregjionit Jugor, Zenel Zenelaj, ka falënderuar CDI-në zvicerane si donatorja më e madhe në këtë fushë.



Abrashi e njofton përfaqësuesin e BE-së për projektet e Ministrisë së Infrastrukturës



Prishtinë, 20 tetor (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka pritur në takimin shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë/përfaqësuesin e ri të posaçëm të BE-së në Prishtinë, Tomas Szunyog.

Në takim u diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, në kompletimin e

infrastrukturës rrugore dhe projektet që ministria mbulon. Ministri Abrashi e njoftoi përfaqësuesin e Bashkimit Evropian për prioritetet dhe objektivat e Ministrisë së Infrastrukturës e që janë modernizimi i hekurudhave dhe lidhja e Kosovës me autostradat e vendeve të regjionit. Abrashi ka theksuar se me Bashkimin

Evropian do të punojnë ngushtë, duke bërë me dije se Republika e Kosovës është e përkushtuar në rrugën drejt integritimit.

Ndërkaq Szunyog ka thënë se Zyra e Bashkimit Evropian e rikonfirmon mbështetjen për Kosovën në rrugën e integritimit dhe modernizimit të infrastrukturës, duke vlerësuar se BE-ja mbetet partnere e Kosovës.

KDI-ja: LDK-ja dhe AAK-ja të 'heqin duart' nga bordet publike

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar, nëpërmjet një komunikate për media, se sipas raporteve vendore, por edhe atyre ndërkombëtare, Kosova vazhdon të përballet me elemente të kapjes së shtetit, përderisa është etabluar praktika e kapjes së bordeve të ndërmarrjeve publike dhe vendosja e njerëzve jokompetentë dhe partiakë. "Ndërmarrjet publike janë institucionet më të kritikuara për performancë të dobët, të cilat operojnë me humbje financiare, madje disa prej tyre ndodhen buzë falimentimit. Sidoqoftë, të njëjtat po vijojnë të shërbejnë si strehë për akomodimin e njerëzve partiakë nga subjektet politike që qeverisin vendin. Kjo është reflektuar edhe gjatë emërimeve të fundit të bordeve

të ndërmarrjeve të rëndësishme si 'Trepça', 'Infracos' dhe Posta e Kosovës, ku janë caktuar individë të cilët kanë garuar për poste publike nën logon e LDK-së dhe të AAK-së", thuhet në komunikatën e KDI-së. Sipas KDI-së, vendosja e individëve me prapavijë partiakë në pozita të përkohshme në këto borde, pa respektuar procedurat e konkursit publik, është në kundërshtim me ligjet e këtyre ndërmarrjeve publike dhe në kundërshtim me premtimin kryesor që bordet do të ç'kapen nga politika dhe do të jenë profesionale, të pavarura dhe me integritet. "KDI-ja i bën thirrje qeverisë që ta respektojë ligjin dhe t'i mbajë zotimet e dhëna për ç'kapjen e shtetit dhe ndërmarrjeve publike nga politika", theksohet në komunikatën e KDI-së.



Ministri i Bujqësisë premton përkrahje për Anamoravën



Gjilan, 20 tetor (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka zhvilluar të martën vizitë pune në regjionin e Anamoravës, ku ka takuar kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, atë të Kamenicës, Qëndron Kastrati, të Komunës së Vitisë, Sokol Haliti dhe atë të

Ranillugut, Vladica Artonoviç, si dhe me përfaqësues të komunave Artanë e Partesh. Përfaqësuesit e regjionit të Anamoravës e kanë njoftuar ministrin Mustafa për gjendjen në komunat e tyre ku, mes të tjerash, u fol edhe për sektorin e bujqësisë dhe sfidat e fermerëve. Nga ana tjetër, ministri Mustafa

ka thënë se nuk do të kursehet, as ai dhe as ministria, për t'u dalë krah fermerëve për tejkalimin e sfidave me të cilat ballafaqohen fermerët në regjionin e Anamoravës. Ministri Mustafa u zotua se brenda mundësive që ka Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do ta

përkrahë këtë regjion në të gjitha nivelet e mundshme. Para përfaqësuesve të këtij regjioni, ministri foli edhe për subvencionet, pagesa e të cilave ka filluar këtë javë, kurse fermerët do të subvencionohen dy herë. Mustafa foli edhe për master planin e ujitjes së tokave

bujqësore, plan i cili pritet të realizohet gjatë dhjetë vjetëve të ardhshme dhe nga i cili Anamorava si regjion, do të përfitojë fuqishëm. Përfaqësuesit e regjionit të Anamoravës, vizitën e ministrit Mustafa e cilësuan të vlefshme dhe inkurajuese për fermerët e kësaj ane.

Në Drenas shënohet Muaji i Ndërgjegjësimit Kundër Kancerit të Gjirit

DRENAS, 20 TETOR (ER) - Muaji tetor është muaji i fushatës ndërkombëtare që ka për qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin për zbulim të hershëm, trajtim të kancerit të gjirit dhe për kujdes shëndetësor të grave dhe vajzave në gjithë botën. Edhe në Komunën e Drenasit, stafi i Zyrës për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave, respektivisht drejtoreshën Kadire Tahiraj dhe shoqërinë civile, kanë mbajtur një sesion informues lidhur me kancerin e gjirit. Të pranishmit i përshëndeti kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz

Lladrovci.

Ndër të tjera, kryetari Lladrovci theksoi rëndësinë e diagnostikimit të hershëm të kancerit të gjirit dhe për rëndësinë që Komuna e Drenasit i kushton kësaj çështje dhe qasjen më të lehtë në diagnostifikim pasi që tani QKMF-ja e Drenasit ka mamograf.

Radiologu Shkëlzen Gashi, nga Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare në Drenas, ofroi për të pranishmet informacione lidhur me zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe për rëndësinë e parandalimit përmes diagnostikimit të kësaj sëmundje, edhe duke përcjellë



informacione për gjeneratat e reja, që ato të vetëdijesohen se si mund të bëjnë vetëkontroll dhe ta shtojnë vetëkujdesin për

shëndetin personal. Për shkak të pandemisë këtë vit nuk ishte e mundur që të bëhet ecja tradicionale kundër kancerit të

gjirit. Për çdo vit fushata e kancerit të gjirit fillon më 1 tetor dhe përfundon më 31 tetor.

Filloi shenjzimi i rrugëve në qytetin e Malishevës

MALISHEVË, 20 TETOR (ER) - Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve, në qytetin e Malishevës ka filluar shenjzimi i rrugëve, përkatësisht pjesa e vendosjes së vendkalimeve për këmbësorë në rrugët e qytetit. Projekti i mirëmbajtjes do të vazhdojë me shenjzimet në rrugë edhe në afërsi të të gjitha shkollave në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës.



Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Malishevës, Milazim Morina, ka bërë me dije se mirëmbajtja e rrugëve, përkatësisht vendosja e sinjalistikës, do të vazhdojë për dy vjet me radhë me këtë

projekt dhe, përveç vendkalimeve, do të vendosen edhe shenjat afër shkollave. "Qëllimi i këtij projekti është jo thjesht mirëmbajtja e rrugëve, por krijimi i sigurisë më të madhe për të gjithë këmbësorët, e sidomos për

nxënësit si në qytet ashtu edhe në fshatra e, po ashtu, edhe vozitësit do ta kenë më të lehtë vozitjen afër shkollave, por edhe në rrugët në qytet", ka thënë drejtori Morina. Sipas tij, kjo mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Fillojnë punimet e asfaltimit në rrugën "Agim Ramadani"

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se të martën kanë filluar punimet e asfaltimit në rrugën "Agim Ramadani", prej udhëkryqit të rrugës "Arkitekt Karl Gega" deri te udhëkryqi i rrugës "Bajram Kelmendi" dhe

shtegu/kahja tjetër prej udhëkryqit të rrugës "Arkitekt Karl Gega" deri te udhëkryqi i rrugës "Qamil Hoxha" (Lokacioni te Pishat). "Punimet po vazhdojnë dhe pritet të përfundohen sipas planifikimeve", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Vazhdon rregullimi i shkollës fillore "Metush Krasniqi" në Roganë

KAMENICË, 20 TETOR (ER) - Punimet për rregullimin e shkollës fillore "Metush Krasniqi" në Roganë janë duke vazhduar.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se ky investim është tejet i rëndësishëm për mësimnxënie cilësore. "Pas investimeve në disa shkolla të

komunës sonë, po vazhdon rregullimi edhe i shkollës fillore "Metush Krasniqi" në Roganë. Rregullimi i hapësirave të kësaj shkolle po bëhet nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë, investim ky tejet i rëndësishëm për mësimnxënie cilësore. Vazhdojmë me punë", ka thënë Kastrati.

Dy shkolla në Vushtrri, për shkak të rasteve me Covid, kalojnë në mësimin online

VUSHTRRI, 20 TETOR (ER) - Shkolla Fillore "Ali Kelmendi" dhe ShFMU "Andon Zako Çajupi" në Vushtrri, për shkak të rasteve të infektimit me Covid-19, nga dje kanë kaluar nga skenari A në skenarin C (mësim online) për dy javë. Lajmi është bërë me dije përmes njoftimit të këtyre shkollave në faqet e

tyre "Facebook". ShFMU "Andon Zako Çajupi" ka njoftuar se kanë të konfirmuar nëntë raste me Covid-19. Të dyja këto shkolla janë mbyllur duke marrë për bazë rekomandimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë.



KURTHET E LAJÇAKUT DHE HUTIA E PRISHTINËS

Shoqëria civile, mediat, intelektualët (me disa përjashtime) më tepër kanë qenë të koncentruar në acarimin e klimës politike në vend, përmes një debati refuzues e joparimor, sesa në krijimin e një strategjie të përbashkët për të luftuar tendencat dezintegruese të Serbisë brenda territorit të Kosovës. Pa një koncentrim të vëmendjes politike e intelektuale në Prishtinë nuk mund të ndodhë ndërgjegjësimi në Beograd, por edhe në një pjesë të diplomacisë së BE-së



Nga Mehmet PRISHTINA

Miroslav Lajçak po e trajton Republikën e Kosovës si të ishte një krijesë fiziologjike-juridike që ende nuk ka marrë formën e duhur, prandaj, sipas tij, duhet të pësojë ndryshime, në mënyrë që të jetë sa më e përshtatshme për serbët. Diplomati e kalibrit të Lajçakut, të paktën që mund të kenë nxënë gjatë përvojës së tyre, është gjuha diplomatike.

Në rastin konkret, jo vetëm që gjuha diplomatike është zhveshur tërësisht nga lëvizja e njëanshmërisë, por ajo ka rrezik të shkaktojë keqkuptime edhe më të mëdha në të ardhmen.

Sipas Miroslav Lajçakut, Kosova duhet të vazhdojë t'i ngajë një pasteline, e cila sa herë që ndodhet në duart e serbëve, duhet të pësojë deformime. Sepse, siç tha ai, Kushtetuta nuk është Bibël që të mos ndryshojë.

Nuk besojmë se emisari evropian i BE-së ka ardhur aq i papërgatitur sa të mos dijë se Bashkësia e komunave me shumicë serbe do të formohet, por vetëm sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ky ka

qenë edhe verdikti i Gjykatës Kushtetuese, e cila shumë qartë e ka nda shapin nga sheqeri, duke saktësuar qartë se çka është dhe çka nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

Miroslav Lajçak sigurisht ka dëgjuar edhe për Marti Ahtisarin, i cili në Pakon e tij kishte përfshi organizimin pushtetit vendor, duke iu lënë hapësirë të mjaftueshme vetadministrimi serbëve, madje edhe me çmimin e cenimit të kompaktësisë territoriale të shtetit të Kosovës. Sipas kësaj Pako objektet sakrale serbe, përfshi manastiret më të rëndësishme kishin status të eksterritorialitetit, që gëzonin madje edhe mbrojtjen ndërkombëtare nga forcat e KFOR-it.

Tani Lajçak kërkon edhe më shumë. Atij i duken pak këto lëshime që i janë bërë serbëve, që nga Gjashtë pikëshi i Ban Ki Munit e deri te pakoja e Ahtisarit, ku Kosova është trajtuar si një territor eksperimental në të cilin kanë të drejtë të gjithë të sillen si në shtëpi të tyre, përpos shqiptarëve.

Burimi i gjithë kësaj qasje të deformuar ndodhet në

Prishtinë. Klasa politike e Kosovës kishte shansin të tregoj sens të lartë shtetndërtimi, mirëpo e humbi këtë shans në momentin kur filloi të rinegocojë me Serbinë për statusin e Kosovës. Dhe kjo ka ndodhur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës (2008) dhe pas verdiktit të GJND-së në favor të Kosovës (2010).

Askush deri më tani nuk ka dhënë sqarim se pse kjo ka ndodhur, por ajo që është e sigurt janë pasojat katastrofale të këtij qëndrimi defanziv të klasës politike të Kosovës, e cila ishte në pushtet pas pavarësisë e këndej.

Por, nuk është përgjegjësia vetëm e klasës politike. Shoqëria civile, mediat, intelektualët (me disa përjashtime) më tepër kanë qenë të koncentruar në acarimin e klimës politike në vend, përmes një debati refuzues e joparimor, se sa krijimin e një strategjie të përbashkët për të luftuar tendencat dezintegruese të Serbisë brenda territorit të Kosovës.

Diplomacia ndërkombëtare, sidomos ajo e disa vendeve të Evropës, prej ku vjen edhe Miroslav Lajçak, nuk e kanë

pasur ndjeshmërinë e duhur për të qenë të drejtë në raport me Kosovën. Kjo diplomaci ka kohë që ushqen njëfarë iluzioni se Kosovës i është dhënë tepër në vitin 1999 me bombardimin e Serbisë, andaj tani është koha, gjithmonë sipas kësaj diplomacie, që ajo çka i është dhënë tepër Kosovës t'i merret. Kjo është mendësia me të cilën aktualisht udhëhiqet edhe Lajçaku, i cili nuk e ka fare problem që ta trajtojë Kosovën si një vilajet të errët të Ballkanit, ndërkohë që ai ende nuk ka kërkuar nga krerët serbë që ta heqin Kosovën nga Kushtetuta e Serbisë.

Prishtina zyrtare, që aktualisht është disi e hutuar, duhet definitivisht të zgjohet nga letargjia që e ka kapluar, sidomos ato institucione që janë të lidhura me drejtpërdrejt me politikën e jashtme, por edhe një pjesë e elitës intelektuale e akademike, në mënyrë që kurthet e Miroslav Lajçakut të refuzohen fuqishëm. Pa një koncentrim të vëmendjes politike e intelektuale në Prishtinë, nuk mund të ndodhë ndërgjegjësimi në Beograd, por edhe në një pjesë të diplomacisë së BE-së.

Në Lipjan po zhvillohen aktivitete për edukim shëndetësor



LIPJAN, 20 TETOR (ER) - Me për përkrahje të kryetarit Imri Ahmeti dhe në bashkëpunim me organizatat AQH dhe KOPE, ka filluar zhvillimi i aktiviteteve në vendbanimet rurale për edukim dhe promovim shëndetësor për qytetarët e Komunës së Lipjanit me moton "Sa më i lartë niveli i edukimit, aq më e shëndetshme është popullata". Drejtoresha e Shëndetësisë, Merita Bytyqi, ka thënë se promovimi shëndetësor

është ndër detyrat dhe përgjegjësitë tona. "Si drejtoreshë e Departamentit të Shëndetësisë, por edhe si profesioniste shëndetësore, me të gjithë aktorët ndihmës do të përpiqemi dhe do të kontribuojmë për parandalimin e sëmundjeve, me synimin kryesor ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve tanë", ka thënë drejtoresha Bytyqi. Aktiviteti lidhur me ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin e komunitetit

për ta njohur më mirë sëmundjen "Hipertensionin" (shtypja e lartë e gjakut), ka filluar ditë më parë në fshatin Gadime, ndërkaq sot (e mërkurë) do të vazhdojë në Janjevë dhe pastaj në vendbanimet e tjera. Aktivitetet po zhvillohen me protokoll të ruajtjes së shëndetit publik, me të gjitha masat dhe rekomandimet mbrojtëse të cilat janë paraparë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Rreth 1500 ekonomi familjare, biznese dhe objekte institucionale futen në menaxhim të ujësjellësit në Kaçanik

KAÇANIK, 20 TETOR (ER) - Është nënshkruar marrëveshja për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Dubravë, Doganaj, Elezaj, Nikaj, Rekë, Soponicë dhe Stagovë. Nënshkrimi u bë nga kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, nga kryeshefi ekzekutiv i KRU "Bifurkacioni" - Ferizaj Xhabir

Morina dhe kryetarët e këshillave të fshatrave. Me këtë rast komuna e Kaçanikut ka dorëzuar edhe projektin e shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit për këto lokalitete. Me këtë marrëveshje, nën menaxhim të ujësjellësit, futen afër 1 500 ekonomi familjare, biznese dhe objekte institucionale që veprojnë në këto vendbanime.





Donald Trump dhe Boris Johnson

Marrëdhënia speciale SHBA me Britaninë e Madhe është më e brishtë se kurrë

Çdo katër vjet, bota shikon se si amerikanët vendosin se kush do të zërë zyrën më të fuqishme në botë. Askund kjo ndjeshmëri nuk është më e madhe se në Mbretërinë e Bashkuar, një vend që kaq shpesh flet për "marrëdhënien e saj speciale" me Shtetet e Bashkuara, një referencë për termin e shpikur nga Winston Churchill në 1946.

Kjo aksiomë asnjëherë kjo nuk ka qenë më e vërtetë se në vitin 2020. Në vitet e ardhshme, Mbretëria e Bashkuar do të riformojë pozicionin e saj në mënyrë dramatike në botë, pasi periudha e tranzicionit Brexit skadon më 31 Dhjetor dhe vendi ndërpret lidhjet e tij të fundit me Bashkimin Evropian.

Është e arsyeshme që Mbretëria e Bashkuar të kthehet tek aleati i saj më i rëndësishëm për mbështetje gjatë kësaj periudhe; mandati presidencial i cilitdo që fiton më 3 nëntor skadon afërsisht në të njëjtën kohë kur britanikët pritet të shkojnë në qendrat e votimit në 2024.

Kjo do të thotë që ose Donald Trump ose Joe Biden do të luajnë një rol të madh ndikues në politikën e Brexit të Mbretërisë së Bashkuar para fundit të vitit. Ata ka të ngjarë të bëjnë të njëjtën gjë për të gjithë politikën e jashtme britanike pas hyrjes në Shtëpinë e Bardhë.

Kur Churchill përdori fjalët "marrëdhënie speciale", ai e bëri këtë në tokën amerikane së



Winston Churchill dhe Harry Truman

bashku me mikun e tij, Presidentin Harry Truman. Lufta e Dytë Botërore përfundoi një vit më parë këtij termi, por Evropa ishte ende jashtëzakonisht e brishtë. Një Rusi agresive Sovjetike po i bënte të qarta synimet e saj për të rritur kontrollin në Evropën Qendrore dhe Lindore, ndërsa promovonte ideologji alternative politike në Lindjen e Largët. Dhe ndërsa nazistët ishin mundur, shumë grupe dhe parti fashiste mbetën të fuqishme në të gjithë kontinentin. Zgjidhja? "As parandalimi i sigurt i luftës, as ngritja e vazhdueshme e organizatës botërore nuk do të fitohen pa atë që unë e kam

quajtur shoqata vëllazërore e popujve anglishtfolës. Kjo do të thotë një marrëdhënie e veçantë midis Komonuelthit Britanik e Perandorisë dhe Shteteve të Bashkuara", tha Churchill. Një aleancë e tillë përfshinte, shpjegoi ai, "vazhdimin e marrëdhënies intime midis këshilltarëve tanë ushtarakë, duke çuar në një studim të përbashkët të rreziqeve të mundshme", si dhe "shkëmbimin e oficerëve dhe kadetëve në kolegjet teknike". Me siguri, të dy kombet që atëherë kanë bashkëpunuar në një gamë të gjerë të çështjeve të sigurisë, ekonomisë, kulturës dhe diplomacisë.

Gjatë Luftës së Ftohtë, Margaret Thatcher dhe Ronald Reagan qëndruan krah për krah kundër Bashkimit Sovjetik, duke festuar kapitalizmin e tregut të lirë dhe demokracinë perëndimore. Ndoshta shenja më e fortë e partneritetit të tyre ishte se Thatcher ishte e vetmja udhëheqëse e huaj që foli në varrimin e Reagan në 2004.

Pas sulmeve të shtatorit 2001, Toni Bler ishte mbështetësi më i fortë ndërkombëtar i Presidentit George W. Bush dhe një nga pak udhëheqësit evropianë që ndoqi Amerikën në Irak. Përtej liderëve politikë, të dy vendet së bashku formuan themelet e NATO-s dhe rrjetit të ndarjes së inteligjencës Five Eyes, institucione që i kanë rezistuar kohës, pavarësisht se kush është në krye të secilës qeveri.

"Padyshim që Bler dhe Bush kishin një partneritet të pakrahasueshëm gjatë luftës në Irak. E njëjta gjë vlen për Thatcher dhe Reagan gjatë Luftës së Ftohtë", thotë Malcom Rifkind, një ish-sekretar i Jashtëm britanik. Dhe edhe pse "nuk ndodh me çdo kryeministër dhe çdo president," pranon Rifkind, "marrëdhënia intime institucionale mbi sigurinë dhe një gamë të gjerë të çështjeve ndërkombëtare ka ngecur".

Sidoqoftë, pyetja që shumë politikanë britanikë po pyesin është, jashtë sigurisë, sa mund të mbështeten në SHBA. për të mbrojtur interesat e Mbretërisë së

Bashkuar në një botë pas Brexit? Me fjalë të tjera, sa e veçantë është marrëdhënia në të vërtetë?

Me interes të veçantë është grindja aktuale mbi planin e Johnson për të kapërcyer një pjesë të marrëveshjes së Brexit që ai nënshkroi me Bashkimin Evropian, i quajtur Protokollin e Irlandës së Veriut. Kritikët thonë se plani i Johnson rrezikon një zonë kufitare në ishullin e Irlandës – midis Irlandës së Veriut, e cila është pjesë e Mbretërisë së Bashkuar, dhe Republikës së Irlandës, një vend anëtar i BE.

Kjo marrëveshje prish Paktin e së Premtes së Mirë të vitit 1998 të ndërmjetësuar nga Presidenti i atëhershëm i SHBA, Bill Clinton. Kjo marrëveshje i dha fund dhjetëvjeçarëve të dhunës sektare dhe gjeti një mënyrë që Unionistët dhe Republikanët të punojnë së bashku në qeverisjen e Irlandës së Veriut.

Ministrat e qeverisë së tij kanë pranuar se një marrëveshje e re do të shkelte ligjin ndërkombëtar. Dhe për fat të keq për Johnson, lobi irlandezo-amerikan ka shumë ndikim në Washington DC.

"Unë nuk mendoj se publiku britanik e kupton rezervuarin e mbështetjes publike për Irlandën në Amerikë. Duke u rritur në Amerikë, unë shkova në shumë parada të Ditës së Shën Patrikut, por nuk di asgjë për Ditën e Shën Gjergjit", thotë Thomas Scotto, Profesor i Shkencave Politike në

Universitetin e Glasgow.

"Britania sigurisht ka një lidhje të rëndësishme gjaku me SHBA, por mbetet e paparashikuar se çfarë ndodh nëse SHBA. detyrohen të zgjedhin midis Irlandës dhe Britanisë".

Këtë mund ta zbulojmë së shpejti. Në javët e fundit, Biden dhe Kryetarja e Dhomës Nancy Pelosi, ndër të tjera, i kanë kujtuar Mbretërisë së Bashkuar se prishja e Marrëveshjes së të Premtes së Mirë do të thotë se nuk do të ketë marrëveshje tregtare me SHBA.

"Ndërsa Irlanda ka qenë e ka shfrytëzuar fuqinë e saj diplomatike, kjo mbështetje e fundit publike e Marrëveshjes të së Premtes së Madhe është drejtuar kryesisht nga politikanë amerikanë", thotë Jennifer Cassidy, një studiuese akademike dhe diplomatike Irlandeze në Universitetin e Oksfordit. "Unë me siguri do të thosha se kjo i jep irlandezëve besimin se një kufi i fortë vihet në vend, dhe fuqia më e madhe e botës do të jetë një aleat i vërtetë për të".

Çështja se ajo që do të mbështeste Amerika, shtrihet përtej Çështjes Irlandeze dhe është pa dyshim dhimbja e kokës më e madhe për Johnson ndërsa ai komploton të ardhmen e Britanisë. Dhe mbase e panjohura më e madhe është saktësisht se çfarë do të bënte një Trump i rizgjedhur.

Ne e dimë që Presidenti mbështet Brexit dhe nuk i pëlqen Bashkimi Evropian. Ne gjithashtu e dimë që ai pëlqen të krijojë përshtypjen se ai dhe Johnson kanë një marrëdhënie të ngushtë, duke e quajtur vazhdimisht mikun e tij. Në një listë të gjatë krahasimesh



Mbretëreshë Elizabeta II dhe Donald Trump

"Trump nuk është një figurë popullore jashtë SHBA. Në sondazhin tonë të fundit 61% e britanikëve menduan se Trump ka qenë një president i tmerrshëm. Vetëm rreth 8% thanë se ai ka qenë i mirë ose i shkëlqyeshëm", thotë Chris Curtis, Menaxher i Kërkimeve Politike në sondazhin YouGov .

që bëhen nga çifti, në mënyrë të drejtë ose të padrejtë, ata janë të vetmit dy udhëheqës botërorë që janë shtruar në spital nga koronavirusi.

Nëse ai fiton rizgjedhjen në nëntor, është e mundur që Trump do të shihte një avantazh strategjik në marrëdhëniet me të ngushta me Mbretërinë e

Bashkuar në një mënyrë që do të minonte BE. Kjo, nga ana tjetër, mund të çojë në një marrëdhënie të dobishme ekonomike për Mbretërinë e Bashkuar. Sado e mirë që mund të jetë kjo për Johnson, ai mbart rrezik. Edhe nëse Johnson do të kishte mendimin se publiku britanik mund të anashkalonte toksicitetin e Trump, nëse ai mbështeste vendin pas Brexit, ka prova të pakta që kjo do të fitonte mbi votuesit. "Britanikët tashmë mendojnë se kemi një marrëdhënie shumë të ngushtë me Amerikën dhe vetëm 21% duan ta shohin atë më afër," thotë Curtis. "Nëse u jepet një zgjedhje, hulumtimi ynë tregon se Britanikët do të preferonin të kishin një marrëdhënie më të ngushtë me Evropën".

Johnson tashmë mund ta dijë këtë. Rifkind beson se nëse Trump do të bëjë përpjekje për Britaninë, "Johnson është të paktën aq i zgjuar sa të dijë që të jesh shok me Trump nuk është diçka që e ndihmon atë me publikun britanik". Dhe ky është një publik me të cilin Johnson, ose pasardhësi i tij konservator, do të duhet të përballet në 2024.

Për drejtësi ndaj Johnson, ai nuk ka treguar shumë oreks për tu afruar me Trump. Ai në më shumë se një rast përkrahu aleatët e tij evropianë Angela Merkel dhe Emmanuel Macron për disa çështje ndërkombëtare, përfshirë Iranin. Ai gjithashtu nuk pranoi të takohej me Trump gjatë samitit të lidhshimit Konservator 2019, pasi ekipi i tij vendosi se do të bënte më shumë dëm sesa dobi.

Më pak mister është se çfarë pozicioni do të merrte Biden, si ndaj Irlandës së Veriut ashtu edhe ndaj Brexit si një e tërë. Ne e dimë që ai është kundër shkeljes së Protokollit të Irlandës së Veriut

nga Britania dhe ne e dimë që një Biden- President, do të kërkojë një kthim në multilateralizëm.

Nëse Johnson do të donte të bashkohej me Biden për të rivendosur këtë lloj rendi në botë, nuk do të ishte jopopullore me pjesë të mëdha të publikut britanik. "Hulumtimet tregojnë se publiku britanik është më mbështetës i presidentëve demokratë të SHBA," thotë Scott. "Ekziston një përqindje e vogël e Brexit-erëve të fortë që mbështesin Trump dhe axhendën e tij nacionaliste dhe ata mund të kenë ndonjë ndikim brenda Partisë Konservatore, por në përgjithësi është një grup



margjinal."

Fatkeqësisht për Johnson, disa nga ata zëra janë mbështetës të Partisë së tij Konservatore dhe njerëz që votuan për të në dhjetor, kur ai drejtoi një fushatë elektorale me një premtim për "Ta mbyllim Brexit". Dhe sidoqoftë pikëpamjet e tyre marginale mund të jenë në mesin e publikut në përgjithësi, sistemi politik britanik e bën shumë të vështirë për një udhëheqës të qeverisë pa mbështetjen e gjerë dhe të plotë të partisë së tyre.

Tani, Kryeministri ka vendosur, disi në mënyrë të pashpjegueshme, të rihapë debatin për Brexit, me mbështetësit e tij që bëjnë presion për një qëndrim më të ashpër.

Gjë që na sjell në një paradoks. Një Brexit i fortë i jep Mbretërisë së Bashkuar më shumë liri për t'u

marrë me partnerët globalë, por më e vështira e Brexit potencialisht përziën aftësinë e Mbretërisë së Bashkuar për t'u marrë me partnerin e saj më të rëndësishëm nga të gjithë, të paktën në rastin e një presidence të Biden.

Më keq për Johnson, disa besojnë se edhe në rastin e një fitoreje të Trump, marrëdhënia speciale mund të mos ishte vërtetë aq e veçantë sa Trump ta mbështeste atë. "Unë kurrë nuk jam rritur duke menduar se kishte një marrëdhënie të veçantë, as prindërit e mi. E gjithë ajo që dinim për Mbretërinë e Bashkuar ishte Mbretëresha dhe një komedian i tmerrshëm i quajtur Benny Hill", thotë Scott Lucas, Profesor i Studimeve Amerikane në Universitetin e Birmingham.

"Sigurisht, ju keni marrëdhëniet e sigurisë dhe marrëdhëniet midis institucioneve. Por nuk është një marrëdhënie e barabartë. Sigurisht që SHBA dëshiron një marrëdhënie të mirë me Mbretërinë e Bashkuar, por gjithashtu dëshiron një marrëdhënie me Japoninë, Gjermaninë ose Izraelin. Britania nuk është domosdoshmërisht porti i parë i thirrjes me SHBA, e lëre më me publikun amerikan". Siç u theksua shumë herë gjatë presidencës së Barack Obama, nëse SHBA. dëshiron një linjë në atë që po ndodh në Evropë, ajo mund të marrë shumë lehtë telefonin dhe të telefonojë Gjermaninë, ashtu si Trump arriti të gjente gjuhë të përbashkët me udhëheqësin francez Emmanuel




Margaret Thatcher dhe Ronald Reagan

Macron në fillim të presidencës së tij.

Johnson tashmë po përballë me një vjeshtë të vështirë. Bisedimet tregtare me Brukselin po arrijnë pikën e tyre më të nxehtë, ashtu si koronavirusi po rishfaqet. Ai po përballë me disa rebelime të vogla, por jo të parëndësishme brenda partisë së tij mbi trajtimin e tij të të dyjave këtyre çështjeve.

Ndërsa viti po i afrohej fundit, Johnson do të përfitonte nga mbështetja e vëllait të tij të madh përtej pellgut. Sidoqoftë, ai nuk mund të kërkojë atë mbështetje derisa të votojnë - duke bërë kështu që mund të lëkundet barka me njërin nga këto perspektiva rrënjësisht të ndryshme. Gjë që e lë Kryeministrin në një model mbajtjeje shumë të pakëndshme ndërsa ai përgatitet për disa javët më të vështira me të cilat përballë në një vit tashmë skëterrë. /CNN/ Përkthim i Gazeta Shqip



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Llapi harron çka është fitorja, Arbëria merr tri pikë në Drenicë

Llapi ende nuk e ka shijuar fitoren në edicionin 2020/2021. Prej gjashtë ndeshjeve të zhvilluara, ka grumbulluar vetëm dy pikë. Të përzgjedhurit e Tahir Batatinës përbëjnë skuadrën më të dobët deri tash në Superligë. Ndërsa të martën në Skenderaj, Arbëria e mposhti Drenicën dhe në këtë mënyrë e rrëmbeu pozitën e dytë në renditjen tabelore



ndeshjeve të zhvilluara, Drenica ka grumbulluar tetë pikë dhe zë vendin e gjashtë në tabelë, kurse Arbëria është e dyta me 11 pikë të grumbulluara.

Sot zhvillon dy derbi

Tri ndeshjet e tjera të Superligës për javën e shtatë zhvillohen sot (e mërkurë), kurse dy prej tyre janë derbi. Vëmendja do të jetë në Suharekë, ku lideri i elitës, Ballkani, e pret skuadrën kampione në fuqi, Dritën e Gjilanit. Të dyja këto skuadra do ta kërkojnë maksimumin e pikëve. Vendasit duan ta thellojnë diferencën ndaj kundërshtarëve, kurse mysafirët synim kanë rikthimin në pozitën e dytë dhe ngushtimin e diferencës me kryesuesit. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të Feronikelit dhe Prishtinës. "Nikli" në ndeshjen e fundit luajti bars

SUPERLIGA

Besa - Llapi	2-2
Drenica - Arbëria	0-1
Sot takohen:	
Feronikeli - Prishtina	
Ballkani - Drita	
Gjilani - Trepça '89	

TABELA

		PIKË
1. Ballkani	6	16
2. Arbëria	7	11
3. Drita	4	10
4. Gjilani	6	9
5. Prishtina	5	8
6. Drenica	6	8
7. Trepça '89	6	7
8. Feronikeli	6	6
9. Besa	7	4
10. Llapi	6	2

me Trepçën '89 (0-0), ndërsa Prishtina e mposhti Besën (4-0). Ndeshja e tretë që zhvillohet sot është në mes të Gjilanit dhe Trepçës '89.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 TETOR - Skuadra e Llapit nuk ka arritur as të martën ta shijojë fitoren e parë në Superligën e Kosovës në futboll, pasi Besa e Pejës arritur të marrë një pikë edhe përkundër faktit që mysafirët kishin epërsi prej 0-2. Skuadra e Tahir Batatinës ishte më e mirë në përballje me pejanët gjashtë dyzet e pesë minutave të parë ku shënuan edhe dy gola nëpërmjet Engull

Hotit dhe Arbor Ramadani për 0-2. Besa e shënoi golin e parë në minutën e 73-të nëpërmjet Haxhiut, kurse rezultatit e barazoi në minutat shtesë në 2-2. Besa prej shtatë ndeshjeve të zhvilluara ka grumbulluar katër pikë, kurse Llapi ka zhvilluar gjashtë ndeshje dhe ka arritur t'i arkëtojë vetëm dy pikë. Drenica, pas fitores ndaj Llapit në xhiron e kaluar, sot ka pësuar humbje nga Arbëria në Skenderaj (0-1). Në minutën e 6-të mysafirët kaluan në epërsi me autogolin e shënuar

nga Genc Hamiti. Vendasit u munduan të rikthehen në lojë, por sulmet e tyre në pjesën e parë përfundonin pa ndonjë rezultat. Në fillim të pjesës së dytë Mziu pati rast të mirë për ta barazuar rezultatit, por Kaçiçi e ndali gjuajtjen e tij. Në minutën e 67-të Qemail Elshani e shërbeu për mrekulli Lushtakun, i cili gjuajti jashtë portës. Kuqezinjët nga Drenasi krijuan edhe disa raste, por nuk arritën ta barazojnë rezultatit dhe ndeshja përfundoi me rezultat 0-1. Pas gjashtë

Përurohët Palestra e Sportit në Deçan

DEÇAN, 20 TETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, bashkë me ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi dhe kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, sot përuan Palestrën Sportive në Deçan, e cila ka kapacitet mbi 1 500 ulëse, projekt i infrastrukturës fizike, në të cilin ka investuar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa vlera e investimit është mbi dy milionë euro.



Në fjalën e tij përshëndetëse, kryeministri Hoti vlerësoi punën që është bërë për ndërtimin e këtij objekti sportiv i cili do të jetë në shërbim për sportistët deçanas. "Është kënaqësi dhe nder që

bashkë me ministren Dumoshi dhe kryetarin Ramosaj të jemi në përuarimin e kësaj sale të bukur, në këtë vend të bukur dhe në këtë ditë të bukur. Ministria Dumoshi me entuziazëm po i çon përpara projektet, që pas shumë viteve prej

sa ka filluar të ndërtohet kjo palestër dhe që ka kaluar shumë ministra të kulturës, rinisë dhe sportit, por është me interes që sot është kompletuar kjo sallë, e cila është e standardeve ndërkombëtare", ka thënë

kryeministri Hoti, duke kujtuar faktin se Deçani, Peja dhe kjo rrethinë ka shumë sportistë të cilët në shumë sporte e kanë bërë krenarë të Kosovës.

Duke uruar sportistët për përuarimin e sallës së re, kryeministri Hoti ka deklaruar se, bashkë me kryetarin dhe ministren, sapo të kalojë situata e pandemisë, do të kthehen për të parë lojërë të bukura në këtë sallë. Ndërkaq, ministria Dumoshi u shpreh se ndihet e lumtur që bashkë me kryeministrin Hoti dhe kryetarin Ramosaj po përuarjnë sallën për të cilën është pritur shumë vite. Duke folur për programin e qeverisë, ministria Dumoshi ka thënë se ndër

prioritetet është zhvillimi i sportit dhe se vetëm në Deçan janë 18 projekte që MKRS-ja i përkrah. "Palestra është ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare ku do të zhvillohen ndeshje kombëtare dhe ndërkombëtare, e kjo gjë flet shumë", u shpreh ministria Dumoshi.

Ndërsa kryetari Ramosaj përmendi faktin se nuk ka pasur ndonjë ministër të sportit i cili ka vizituar më shpesh Deçanin sesa ministria Dumoshi dhe se Deçani i shpreh mirënjohjen ministres. Ai ka shtuar se është një nder për Deçanin edhe prania e kryeministrin Hoti në këtë përuarim. Kjo palestër ka nisur ndërtimin në vitin 2010.

Rahoveci dhe Trepça paralajmërojnë se synim kanë fitoren

PRISHTINË, 20 TETOR - Sfida e parë çerekfinale e Superkupës do të zhvillohet sot (e mërkurë) në Gjakovë ndërmjet Rahovecit dhe Trepçës. "Vreshtarët" edicionin e kaluar ishin ndër skuadrat më të dalluara në elitë dhe shpresojnë se do të kenë një edicion sa më pozitiv.

Një nga basketbollistët më të talentuar të Rahovecit është Visar Ejupi. Ai flet për rrjedhën e përgatitjeve dhe ndeshjet në Superkupë. "Përgatitjet kanë

shkuar shumë mirë dhe po përgatitemi për ndeshjen çerekfinale kundër Trepçës. Po shpresojmë për një paraqitje sa më të mirë. E kemi pasur edhe një ndeshje miqësore me Ponten, ku besojmë se jemi të gatshëm për Superkupë dhe edicionin e ri", është shprehur Ejupi për faqen zyrtare të FBK-së.

Trepça në edicionin e kaluar u rendit e shtata, ku në "play-out" mundi dy herë AS Prishtinën dhe siguroi mbijetesën në elitë edhe



për një edicion. Basketbollisti i Trepçës, Valdrin Haxhiu, është shprehur se përgatitjet i kanë filluar që tri javë dhe shpresojnë në rezultate pozitive. "Ne përgatitjet i kemi filluar që në

dritën e parë që kanë dhënë dritën e gjelbër organet përkatëse. Sigurisht se tri javë nuk janë të mjaftueshme, mirëpo do të përpiqemi ta marrim maksimumin e mundshëm për këtë kohë. Tash na pret ndeshja e Superkupës kundër Rahovecit dhe fillimi i kampionatit. Besoj se jemi të përgatitur për t'u bërë ballë sfidave. Njëkohësisht besoj shumë edhe në ngritje të paraqitjeve në vazhdim", deklaroi Haxhiu për faqen zyrtare të FBK-

së. Fituesi i duelit Rahoveci - Trepça në gjysmëfinale do të ndeshet me fituesin e përballjes Sigal Prishtina-Vëllaznimi.

ORARI

Të mërkurën takohen në Gjakovë:
17:00 Rahoveci - Trepça
19:30 Sigal Prishtina - Vëllaznimi

Të enjten takohen në Prizren:
17:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni
19:30 Peja - Bashkimi

Dukagjini transferon Osmanin

KLINË, 20 TETOR - Skuadra e Dukagjinit nga Klina e ka transferuar sulmuesin e njohur Labinot Osmani. "Labi" është një nga sulmuesit më të mirë në dhjetë vitet e

fundit në futbollin e Kosovës, derisa me plotë sukses ka luajtur për Hysin, Prishtinën, Feronikelin dhe Vushtrrinë. "Futbollisti vushtrrias, Labinot Osmani dhe klubi jonë kanë

arritur një marrëveshje. Siç dihet 'Labi' sezonin e kaluar ishte pjesë e Llapit nga Podujeva ku ishte paraqitur në shtatëmbëdhjetë ndeshje, duke shënuar tre gola dhe

asistuar gjashtë herë. Ne i urojmë shumë sukses Labit me fanellën e klubit tonë! Na priftë e mbara se bashku", thuhet në njoftimin e klubit që bën gara në Ligën e Parë.



Bayerni e nisi mbrojtjen e titullit kundër Atletico

MUNCHEN, 20 TETOR (ER) - Kampioni në fuqi i Evropës, Bayern Munchen, e nis sonte (e mërkurë) mbrojtjen e titullit në garën më të fortë në futboll, Ligën e Kampioneve, ndaj skuadrës së Atletico Madridit. Klubi "bavarez" ka treguar një formë të jashtëzakonshme edicionin e kaluar ku arriti ta fitojë Bundesligën, Kupën, Ligën e Kampioneve, Superkupën e Evropës dhe Superkupën e Gjermanisë. Pavarësisht prej këtyre sukseseve, Bayerni në disa



ndeshje nuk ka treguar shumë qëndrueshmëri në repartin e mbrojtjes, ku pësoi humbje të thellë nga Hoffenheimi (4-1), por edhe në finale ndaj Borussia Dortmundit ishte duke fituar 2-0, më pas pranoi dy gola 2-2. Një gol në fund të ndeshjes nga Joshua Kimmich i siguroi trofeun kësaj skuadre. Në anën tjetër edhe Atletico Madridi nuk ka treguar shumë qëndrueshmëri në këtë fillim sezoni. Në formacionin e

Bayernit për këtë ndeshje rikthehet Kimmich në vend të Corentin Tolisso, kurse mungesa e vetme do të jetë ajo e Leroy Sane. Ndërsa në skuadrën e Atletico, vetëm Digo Costa është në dyshim. Në Grupin A takohen edhe Salzburg - Lokomotiv Moskë. Në Grupin B, Real Madridi e pret Shakhtarin, kurse Interi ka punë me gjermanët e Moenchengladbach. Liverpooli do të luajë kundër Ajaxit.

GRUPI A	
18:55	Salzburg - Lokomotiv M.
21:00	Bayern M. - Atletico Madrid
GRUPI B	
18:55	Real Madrid - Shakhtar D.
21:00	Inter - B.Moenchengladbach
GRUPI C	
21:00	Manchester City - Porto
21:00	Olympiacos - Marseille
GRUPI D	
21:00	Ajax - Liverpool
21:00	Midtjylland - Atalanta

Ferizaj dhe Istogu mësojnë kundërshtarët në Kupën e Evropës

PRISHTINË, 20 TETOR - Kampionia e Kosovës në konkurrencë të femrave, KHF Ferizaj, ka mësuar të martën kundërshtarin e raundit të tretë të Kupës Evropiane. Shorti i tërhequr në Vjenë ka caktuar që Ferizaj në raundin e tretë të përballet me skuadrën turke Muratpasa Belediyesi. Ndeshja e parë duhet të luhet në Turqi, kurse e kthimit në Ferizaj. Është hera e parë që Ferizaj do të garojë në arenën evropiane. Ndeshjet e Ferizajt me skuadrën turke Muratpasa do të luhen më 14/15 nëntor dhe një javë më vonë. Kundërshtarin e ardhshëm evropian të martën e mësoi edhe skuadra e hendbollisteve të Istogut. Istogu në raundin e tretë të Kupës Evropiane do të përballet me skuadrën nga Bjellorusia, Victoria-Berestie. Ndeshja e parë



duhet të luhet më 14 apo 15 nëntor në Bjellorusi, ndërsa e kthimit një javë më vonë në Istog. KHF Istogu në raundin e dytë e eliminoi Vushtrrinë. Tani e pret një udhëtim

i largët për në Bjellorusi. Shorti për raundin e tretë të Kupës Evropiane është tërhequr të martën në Vjenë. Për herë të parë Kosova i ka dy skuadra në raundin e tretë.

SHKURT

Trajneri i Veronës: Kumbulla është një fenomen

Trajneri i Veronës, Ivan Juriç, ka folur për mbrojtësin e Kombëtares së Shqipërisë, Marash Kumbulla, nëse ka të krahason me lojtarin 20-vjeçar, Mateo Lovato, që klubi veronez është duke promovuar këtë sezon. Në deklaratën e tij, Juriç e ka cilësuar Marash Kumbullën si një fenomen, që bënte në perfeksion detyrat e trajnerit. "Lovato më pëlqeu shumë. Ai po rritet dhe po bën mirë. Për mua Kumbulla është një fenomen. Kjo nuk do të thotë që Mateo nuk është. Por, Marashi bëri në mënyrë të përsosur atë që i kërkova, rrallë gjen futbollistë me atë mentalitet. Ne besojmë shumë te Mateo, por unë mendoj se ai do të ketë një rrugëtim më të gjatë se ai i Kumbullës", ka thënë trajneri i Veronës.

Emery: Mbappe dëshironte të kalonte në Real

Ish-trajneri i PSG-së, Unai Emery, ka zbuluar së fundmi, se sulmuesi francez Kylian Mbappe i kishte thënë atij se dëshironte të kalonte te skuadra e Realit të Madridit. "Kur isha në drejtimin e PSG-së, Mbappe mendoi seriozisht të kalonte te Real i Madridit. Ai më tha se i pëlqente shumë të kalonte atje dhe ishte i ngazëllyer për interesimin e spanjollëve në drejtim të tij", ka thënë Emery.

Eto'o: Mungesë respekti 'France Football'

"France Football" po organizon "Ballon d'Or Dream Team" dhe një ditë më parë ka publikuar listën e anësorëve të djathtë, ku mes tyre është edhe sulmuesi Samuel Eto'o. Kamerunasi nuk është ndier mirë dhe kjo për shkak të pozicionit. Ai e konsideron veten qëndrueshmësi dhe thekson se kjo është një mungesë respekti ndaj tij. "Faleminderit, por unë kam luajtur një ose dy sezone në të djathtë, megjithëse kam 25 vjet karrierë si qëndrueshmësi. Mungesë respekti 'France Football'", ka thënë Eto'o. Emri i Eto'o's në krahun e djathtë është përkrah futbollistëve të mëdhenj si Beckham, Best, Figo, Garrincha, Jairzinho, Keegan, Matthews, Messi dhe Robben.

Vdes ish-portieri i Francës

Ish-portieri dhe trajneri i portierëve i Francës, Bruno Martini, ka vdekur të martën në moshën 58-vjeçare, pas një sulmi në zemër. Martini e përfaqësoi Francën në 31 ndeshje dhe njihet më së miri për paraqitjet e tij në Kampionatin Evropian 1992 kundër Anglisë, Suedisë dhe Danimarkës. Ai ishte trajner i portierëve në ekipin kombëtar të Francës nga viti 1999 deri në vitin 2010. Franca e fitoi Kampionatin Evropian 2000 dhe ishte finaliste e Kupës së Botës 2016 gjatë asaj kohe. Ai i zhvilloi 139 ndeshje për Auxerre dhe 113 për Montpellier.

Carragher: Liverpooli duhet ta transferojë Upamecanon

Jamie Carragher ka identifikuar lojtarin që mund ta zëvendësojë Virgil van Dijkun. Holandezi ka pësuar një lëndim të rëndë në mesjavë,

në ndeshjen kundër skuadrës së Evertonit. Lojtari holandez do të mungojë 6 deri në 8 muaj. Ish-kapiteni i Liverpoolit, Jamie Carragher,

ka këshilluar skuadrën që t'i nisë tentimet për Dayo Upamecano. "Një qëndrueshmësi duhet të jetë blerja e madhe e radhës nga

Liverpooli. Po flas për verën tjetër", ka thënë Carragher. "Por, është Dayot Upamecano, një profil i shkëlqyer. Duhet paguar para

shtesë dhe të transferojnë atë më 1 janar. Kjo do të thotë se do të kalojmë vetëm 11 ndeshje pa Virgil van Dijk", ka shtuar anglezi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo za Obrazovanje i Nauku / Ministry of Education and Science

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ofron bursa duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr.04/L-037, prioritetet nacionale dhe interesat strategjike të vendit që synojnë mbështetjen e studentëve me bursa studimi për studentët e shkëlqyer në programet e studimit në fusha prioritare, për studentët me aftësi të kufizuara, rritjen e kapaciteteve në shkenca teknike, mbështetur në Udhëzimin administrativ nr. 14/2017 të datës 06.12.2017 dhe vendimin e Ministrit nr. 01B-123 dt. 12.10.2020:

SHPALL
KONKURS

PËR NDARJE TË BURSAVE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË PROGRAMET: BAÇELOR DHE MASTER PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Kushtet dhe kriteret

1. Për fitimin e bursës së MASH, kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të kenë përfunduar vitin e parë në studimet BA dhe vitin e parë për studimet MA;
 - 1.3. Të kenë të përfunduar të gjitha provimet paraprake dhe kreditë e fituara për vit akademik, pa përsëritje të vitit;
 - 1.4. Të drejtë aplikimi kanë studentët e të gjitha fushave të studimit;
 - 1.5. Të gjitha fushat e studimit sipas UA 14/2017, duhet të kenë notën mesatare të studimeve së paku 9.0;
 - 1.6. Kriteret në pikën nr. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, përjashtohen për studentët me aftësi të kufizuara.

Kategoritë e studentëve me përparësi

2. Kategoritë e kandidatëve që do të kenë përparësi për fitimin e bursës nga MASH, në kushte të barabarta me studentët tjerë janë:
 - 2.1. Fëmijët e dëshmorëve të luftës së UÇK-së;
 - 2.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 - 2.3. Veteranët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 - 2.4. Fëmijët e të zhdukurve të luftës;
 - 2.5. Fëmijët e familjeve që janë përfitues të skemave sociale;
 - 2.6. Fëmijët e ish të dënuarve, të burgosurve dhe të përndjekurve politik;
 - 2.7. Fëmijët të cilët janë më tepër se një student nga një familje;
 - 2.8. Kriteret dhe kushtet për studentët me aftësi të kufizuara, janë sipas udhëzimit nr. 14/2017.

Dokumentacioni që kërkohet për të gjithë studentët

1. Formulari i aplikacionit nga MASH, i cili mund të shkarkohet në linkun e MASH-
<https://mash.rks-gov.net/>, për bursë drejtuar MASH.
2. Certifikata e lindjes origjinale.
3. Vërtetimi i statusit të studentit duhet të jetë i afatit të shtatorit për vitin akademik 2020-2021.
4. Certifikata e vërtetuar e notave nga fakulteti për dy nivelet e studimit (BA dhe MA), me notë mesatare dhe kreditë e fituara të cekura.
5. Kopja e letërnjoftimit.
6. Konfirmim nga banka për xhironlogarinë bankare, e cila llogari duhet të jetë aktive. Llogaria bankare duhet të jetë e vet studentit që aplikon.
7. Të gjitha dokumentet që kërkohen me UA. 14/2017, duhet të jenë origjinale dhe të lëshuara nga organet kompetente.

Kandidatët e kategorive sipas nenit 4 të UA 14/2017 duhet të sjellin të gjithë dokumentacionin si më lartë dhe dëshmi valide nga organet kompetente.

Procedurat e aplikimit

- Aplikimi bëhet online në email-in e MASH bursa.mash@rks-gov.net publike.
- Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.
- Nuk kanë të drejtë aplikimi studentët absolvent dhe studentët me studim 1 vjeçar Master
- Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASH.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, nga data 21.10.2020 deri më 04.11.2020, në ora 16:00.

E drejta e ankesës: Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankesë në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASH, kati përdhës, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga komisioni për ankesa dhe parashtrësia i MASH.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo za Obrazovanje i Nauku / Ministry of Education and Science

The Ministry of Education and Science offers scholarships based on the Law on Higher Education no.04 // L-037, national priorities and strategic interests of the country that aim to support students with scholarships for excellent students in study programs in priority areas, for students with disabilities, capacity building in technical sciences, based on Administrative Instruction no. 14/2017 dated 06.12.2017 and the decision of the Minister no. 01B-123, dated 12.10.2020:

ANNOUNCES
COMPETITION

FOR ALLOCATING SCHOLARSHIPS FOR STUDENTS OF PUBLIC UNIVERSITIES IN THE PROGRAMS: BACHELOR AND MASTER FOR THE ACADEMIC YEAR 2020-2021

Conditions and criteria

1. To gain the MES scholarship, candidates must meet these basic conditions and criteria:
 - 1.1. To be citizens of the Republic of Kosovo;
 - 1.2. To have completed the first year in BA studies and the first year in MA studies;
 - 1.3. To have completed all the preliminary exams and credits earned for the academic year, without repeating the year.
 - 1.4. Students of all fields of study are entitled to apply
 - 1.5. All fields of study according to AI 14/2017 must have the average study grade at least 9.0.
 - 1.6. Criteria in point no. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, are excluded for students with disabilities.

Categories of students with priority

2. The categories of candidates that will have priority for gaining the scholarship from MES on equal terms with other students are:
 - 2.1. The children of KLA war martyrs;
 - 2.2. KLA war invalids and their children;
 - 2.3. KLA war veterans and their children;
 - 2.4. Children of war missing persons;
 - 2.5. Children of families that are social scheme beneficiaries;
 - 2.6. Children of former convicts, prisoners and politically persecuted persons;
 - 2.7. Children who are more than one student from one family;
 - 2.8. The criteria and conditions for students with disabilities are according to instruction no. 14/2017.

Documentation required for all students:

1. Application form from MES, which can be downloaded at the MES link - <https://mash.rks-gov.net/>, for scholarships addressed to MES;
2. Original birth certificate;
3. Proof of student status must be of the September deadline for the academic year 2020-2021;
4. Certificate of grades from the faculty for the two levels of study (BA and MA), with average grade and the mentioned credits earned;
5. ID copy;
6. Confirmation from the bank for the bank account, which must be active. The bank account holder must be the student who applies;
7. All documents required by AI 14/2017, must be original and issued by the competent authorities.

Candidates of categories according to article 4 of AI 14/2017 must bring all documentation as above and valid evidence from the competent authorities.

Application procedures

- The application is made online in the email of MES, bursa.mash@rks-gov.net public,
- Incomplete documents will not be reviewed by the commission.
- Graduate students and students with 1 year of Master study are not eligible to apply
- The list of beneficiary students will be made public on the MES website.

The competition will be open for 15 days, from 21.10.2020 to 04.11.2020, at 16:00.

Right to appeal: Candidates who have applied for the scholarship, have the right to appeal within 7 (seven) days after the announcement of the results. Complaints are submitted to the MES archive, ground floor, office no. 4 and are reviewed by the Complaints and Appeals Commission of the MES.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Education Arsimit dhe Shkencës - Ministarstvo Obrazovanja i Nauke Ministry of Education and Science

Ministarstvo obrazovanja i nauke nudi stipendije na osnovu Zakonu o visokom obrazovanju br.04 / L-037, nacionalni prioriteti i strateški interesi zemlje koji imaju za cilj pružanje podrške studentima sa stipendijom za odlične studente za studijske programe u prioritarnim oblastima, za studente sa ograničenim sposobnostima, povećanje kapaciteta tehničkih nauka Podržano Administrativnim uputstvom br.14/2017 dana 06.12.2017 i odlukom Ministra br. 01B-123 dat. 12.10.2020.

OBJAVLJUJE
KONKURS

ZA DODELU STIPENDIJE ZA STUDNETE JAVNIH UNIVERZITETA PROGRAMA:
 BACHELOR I MASTER ZA AKADEMSKU 2020/2020

Uslovi i kriterijumi

- Za dobijanje stipendije MON-a, kandidati moraju ispunjava sledeće uslove i kriterije:
 - Da je državljanin Republike Kosovo;
 - Da je završio je prvu godinu studije BA i prvu godinu studije MA;
 - Da je završio sve prethodne ispite i dobijene kredite za akademsku godinu, bez da je ponovio godinu.
 - Pravo apliciranja imaju studenti svih oblasti studija
 - Sve studijske oblasti prema AU 14/2017 moraju imati prosečnu ocenu studije najmanje 9.0.
 - Kriteriji iz poene br. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 izuzima se za studente sa invaliditetom.

Kategorije studenata koje imaju prednost

- Kategorije kandidata koji će imati prednost u dobijanju stipendije MON-a pod jednakim uslovima sa ostalim studentima su:
 - Deca palih boraca OVK;
 - Ratni invalidi OVK i njihova deca;
 - Ratni veterani OVK i njihova djeca;
 - Deca osoba nestalih u ratu;
 - Deca porodica koje su korisnici socijalnih programa;
 - Deca bivših političkih osuđenika, zatvorenika i prognanika;
 - Deca koja su više od jednog studenta u porodici;
 - Kriteriji i uslovi za studente sa ograničenim sposobnostima, su prema uputstvu br. 14/2017.

Dokumentacija potrebna za sve studente:

- Formular za aplikaciju iz MON, kojeg možete preuzeti na link MON - <https://mash.rks-gov.net/>, za stipendije namenjen MON-u;
- Original izvod rođenja;
- Potvrda o statusu studenta treba da je iz septembarskog roka za akademsku godinu 2020-2021;
- Overena potvrda o položenim ispitima sa fakulteta za obadva nivoa studija (BA i MA), sa prosečnom ocenom i dobijene kredite kao što je navedeno;
- Kopija lične karte;
- Potvrda iz banke o bankovnom računu, koji mora biti aktivan. Bankovni račun mora biti na ime samog studenta koji aplicira;
- Svi dokumenti koje se traže AU. 14/2017, moraju biti original i izdati od nadležne organe.

Kandidati kategorija prema članu 4. AU 14/2017 moraju dostaviti svu gore navedenu dokumentaciju i validne dokaze od nadležne organe.

Procedure apliciranja

- Aplicacije se podnosi online na e-mail MON bursa.mash@rks-gov.net javne,
- Komisija neće razmatrati nepotpuna dokumenta.
- Nemaju pravo na apliciranje studenti koji su apsolvirani i studenti Master studije od 1 godinu
- Spisak studenata koji su dobili će biti objavljen na web stranici MON-a.

Konkurs će biti otvoren 15 dana, od dana 21.10.2020 do 04.11.2020 u 16:00 časova.

Pravo na žalbu: Kandidati koji su aplicirali za dobijanje stipendije imaju pravo na žalbu u roku od 7 (sedam) dana, nakon objave rezultata. Žalbe se dostavljaju u arhivu MON-a, prizemlje, kancelarija br. 4 i Komisija za žalbe i predstavi će razmotriti žalbe i predstavi MON-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR ARSIM

Nr-4-620-51516

Datë: 20.10.2020

Në mbështetje të nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020, Rregullores 15Nr. 670-47372 të datës 30.09.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr. 670-24576 të datës 22.06.2020 për caktimin e numrit të bursave dhe shumës financiare për një bursë për studentë për vitin akademik-shkollor 2020/2021, Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit shpallë:

KONKURS

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Komuna e Lipjanit ndanë 80 (tetëdhjetë) bursa për studentë të cilët studiojnë në Universitetet dhe Kolegjet e Republikës së Kosovës për vitin akademik 2020/2021. Vlera e bursës është 500 € për vitin akademik.

Kushtet dhe kriteret:

1. Të drejtë për të aplikuar për bursë komunale kanë studentë të cilët i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë banorë rezident të Komunës së Lipjanit,
- Të jenë të regjistruar në vitin akademik për të cilin ndahen bursat,
- Të kenë çertifikatën e notave,
- Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër për vitin e njëjtë akademik,
- Të mos jenë të punësuar.

2. Niveli i studimeve për të cilën ndahet bursa është themelore (bachelor), studentë aplikues duhet të jenë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve.

3. Studentët do të vlerësohen me pikë nga Komisioni duke u bazuar në sukseset e arritura në vitin paraprak në pajtim me kriteret e përcaktuar me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020 dhe Rregullores 15Nr. 670-47372 të datës 30.09.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020, në këto fusha të studimit:

Fakulteti i Arteve
 Fakulteti i Shkencave Sportive.....
 Fakulteti Juridik.....
 Fakulteti Ekonomik.....
 Fakulteti Filologjik.....
 Fakulteti i Edukimit.....
 Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.....
 Fakulteti Filozofik.....
 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
 Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.....
 Fakulteti i Mjekësisë.....
 Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore.....
 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.....

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Ekstraktin e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit
- Çertifikata mbi vendbanimin
- Deklaratën e bashkësisë familjare
- Certifikatën e notave
- ID e fakultetit
- Konfirmimin e llogarisë bankare
- Vërtetim nga fakulteti që nuk merrni bursë nga fakulteti
- Dokumentin zyrtar të lëshuar nga organi kompetent si dëshmi se është fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit dhe martirit të luftës së UÇK, është person me aftësi të kufizuara, në asistencë sociale si dhe dëshminë se nuk i ka prindërit në jetë.
- Aplikacioni merret në zyrën e pranimit të Komunës dhe dorëzohet në këtë zyrë në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Shënim:

-Të gjitha dokumentacionet e kërkuara duhet të jenë origjinale

-Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen

Shënim:

Rregulloren për Ndarjen e Bursave për Student mund ta gjeni në faqen e Komunës

Drejtoresha e DKA-së
 Elmaze Behluli

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Gold Stone" L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për përpunimin, thërrmimin dhe sperimin e gurit gëlqeror në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.11.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Bjeshka" i cili ndodhet në anën a djathtë të rrugës Malishevë-Rahovec, komuna e Rahovecit do të organizohet debat publik nga kompania "Gold Stone" L.L.C Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për përpunimin, thërrmimin dhe sperimin e gurit gëlqeror në Rahovec.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WEtvcTI0MSs1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ SH.P. "OK" SH.P.K. me numër Unik të Biznesit 810604000, nr. fiskal 600026536 dhe nr. të TVSH-së, 330041468 ka vendosur për zvogëlimin e kapitalit nga 500.000.00 në shumën 250.000.00 Prizren.

▶ "Business Services" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70775166 dhe nr. fis. 600707931.

▶ "Paper" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. identifikues 810799942 dhe nr. biz. 70617986.

▶ "AJ Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71004406 dhe me nr. fis. 601035901.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrarë. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema kadareane*. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku një tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi

Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë veper unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivura e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.


Dr. Arben Fetoshi

4⁹⁹ €



Triptikon arbëresh

Arben Veselaj



ARBEN VESELAJ TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikja, ikonikja)



Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohemi*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvaqshme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.

Sh. B. Armagedoni


4⁹⁹ €



Linga e heshtjes

Bujar Salihu

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES

(poezi)





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

